



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1110/ 10 prot.

Datë 02.06.2025

V E N D I M
Nr. 731/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.06.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.685/2025, datë 21.05.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me nr. REF-40956-03-12-2025, me objekt: “Materiale konsumi për oficinën TK”, me fond limit 1,600,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “Bajro Bros” ShPK,
adresa: Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial “Magnet”,
Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durrës.
Adresa: Lagjja Nr.1, Rruga Tregëtare, Durrës.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “AS INVEST” ShPK,
adresa: Lagjja 13, Plazh, Z.Kadastrale 8518, Nr.Pasurie
58/338+1-43, kati 8. Durrës.

Operatori ekonomik “Luan Spahia Spahia” P.F,
adresa: Lagjja nr.13, plazh, Nr.pasurie 38/214- ND-N7, Z.
Kadastrale 8518, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 21.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.685/2025, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra. me nr. REF-40956-03-12-2025, me objekt: “Materiale konsumi për oficinën TK”, me fond limit 1,600,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” P.F, duke e kualifikuar atë në zbatim të këtij vendimi.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bajro Bros” ShPK*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.1478 prot., datë 28.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1110/7, datë 30.05.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 685/2025 datë 21.05.2025 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.1478 prot., datë 28.05.2025, protokolluar me tonën nr. 1110/7, datë 30.05.2025, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar Vendimin e KPP-së me Nr. 685/2025 datë 21.05.2025 për procedurën e prokurimit objekt gjykimi, duke kryer rivleresimin e ofertes dhe kualifikuar operatorin ekonomik “Bajro Bros” ShPK. Kërkojme heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit.

II.2. Referuar shkresës sipërcituar AK citon : [...]AK në zbatim të vendimit të KPP-se. ka kryer rivleresimin e ofertes dhe kualifikuar operatorin ekonomik “Bajro Bros” ShPK.

Kerkojme nga ana juaj heqjen e pezullimit te procedures se prokurimit. [...]

Komisioni, nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të ofertës së ankimuesit më datë 27.05.2025 në zbatim të vendimit të KPP-së.

II.3. Sa më sipër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës ka zbatuar vendimin Nr. 685/2025 datë 21.05.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar Mallra, me nr. REF-40956-03-12-2025, me objekt: “Materiale konsumi për oficinën TK”, me fond limit 1,600,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra, me nr. REF-40956-03-12-2025, me objekt: “Materiale konsumi për oficinën TK”, me fond limit 1,600,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 02.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Nënkryetar

Fiorent Zguro

